



BACHELOR
THEOLOGJI SOCIALE
DHE SHKENCA
RELIGJOZE



MASTER SHKENCOR
TURIZËM
RELIGJIOZ



MASTER PROFESIONAL
THEOLOGJI SOCIALE
DHE PRAKTIKE

BULETIN INFORMATIV



Ceremonia e Diplomimit e Kolegjit Universitar “Logos”

Më datë 24 Qershor 2023, në Qendrën Kulturore të Katedrales së Ngjalljes së Krishtit u zhvillua Ceremonia e Diplomimit e Kolegjit Universitar “Logos”. Ky diplomim ishte një ngjarje e veçantë për Departamentin e Theologjisë dhe Kulturës, sepse studentët e parë të tij do të merrnin zyrtarisht diplomat e tyre Bachelor. Gëzimi është i madh, sepse zyrtarisht shpërblehen mundimet, arsimdashja dhe krijimtaria e të diplomuarve të parë të Departamentit tonë, nga vitet akademike 2020-21 dhe 2021-22.

Departamenti i Theologjisë dhe Kulturës ka filluar të funksionojë nga viti akademik 2018-19 si ofrim në studimin dhe hulumtimin e Shkencave Humane, por edhe si ofrim në nevojat e shoqërisë moderne shqiptare.

Media sociale



Tel. +35569 30 30 277

Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë, qysh prej fazave të para të rindërtimit të saj, themeloi Akademinë Theologjike Orthodhokse në Shën Vlash në vitin 1992, në të cilën janë diplomuar të gjithë klerikët e saj dhe shumë kuadro laikë që punojnë në strukturat e saj të ndryshme. Përveç kësaj, Fortlumturia e Tij, Kryepiskopi i Shqipërisë z. Anastas, Profesor Emeritus i Historisë së Religjioneve në Universitetin e Athinës, themeloi edhe Departamentin tonë.

Synimi i tij është t'u ofrojë formim akademik atyre që dëshirojnë të studiojnë më gjerësisht traditën orthodhokse, vlerat njerëzore dhe kulturën që krijoi ajo, kontributin e saj në zhvillimin e një shoqërie të drejtë dhe krijuese, rolin e religjioneve në bashkekzistencën paqësore dhe përparimin e shoqërisë. Përveç programit Bachelor në Theologji, Departamenti ynë ofron Master Shkencor në Turizëm Religjioz dhe pritet që, nga viti i ardhshëm akademik, të ofrojë Master profesional në Theologji Sociale dhe Praktike. Të diplomuarit e saj do të kenë formimin e duhur të punojnë në struktura të ndryshme të Kryepiskopatës, të vazhdojnë studimin e disiplinave të tjera universitare dhe, sigurisht, të japin lëndën fetare në shkollat e Shqipërisë, në të ardhmen, kur kjo lëndë të përfshihet në programet shkollore në njëfarë forme, siç është në Evropë. Mbështetja morale dhe kontributi thelbësor i Kishës, si edhe interesimi i vazhdueshëm i Kryepiskopit Anastas me bursa studimi dhe me çdo mbështetje tjetër materiale e morale, ishin të pandara. Pikërisht me këto ndjenja mirënjohjeje i shohim me gëzim të veçantë të diplomuarit tanë të sotëm, të cilëve u përket kjo ditë festive.

Theologjia është zëri i Kishës për mënyrën e jetesës së njeriut në Krishtin dhe në Frymën e Shenjtë. Bota jonë karakterizohet nga konflikte, nga qëndrime ekstreme dhe absolute, ku çdo gjë gjykohet në mënyrë egocentrike, sipërfaqësore dhe, shpeshherë, të padrejtë. Në këtë botë është e nevojshme fjala, por edhe praktika, që kërkojnë zgjimin dhe transformimin shpirtëror të njeriut, që mësojnë të vërtetën se njerëzimi është krijuar nga Perëndia, ndaj njeriu merr në jetën e tij dhuratat e Perëndisë: dashurinë e Tij, paqen, drejtësinë, shpengimin, fuqinë e Ngjalljes dhe shpresën e përjetësisë.

Panairi i shën Joan Vladimirit

Panairi i Shën Joan Vladimirit i mbajtur sivjet në datat 3 dhe 4 qershor, dhe i vendosur në kalendarin e aktiviteteve turistike të Shqipërisë, ka pasur një program të larmishëm aktiviteteve. Peregrinë, besimtarë dhe turistë të zonave të Elbasanit dhe më gjerë, duke kaluar edhe kufijtë e Shqipërisë me besimtarë të Malit të Zi, vizituan që nga mesdita dhe deri në mesnatë kishën dhe ambientet e manastirit. Përfaqësues nga Departamenti i Theologjisë dhe Kulturës bënë prezantimin e programeve të studimit dhe ishin të gatshëm për guidë mbi manastirin për vizitorët vendas dhe të huaj. Gjithashtu, nga seria e dokumentarëve «Art dhe Trashëgimi» u transmetua dokumentari «Dashuri dhe monumente». Agripnia (shërbesa fetare dhe meshë hyjnore) e cila përfundoi pas mesnate dhe u kryesua nga Mitropoliti i Elbasanit Hirsësia e Tij Andoni, pati një pjesëmarrje të konsiderueshme të besimtarëve të ardhur nga Elbasani, Tirana dhe më gjerë. Të nesërmen pas Meshës Hyjnore u krye në nderim të shenjtit procesioni i Arkës së Lipsanit të Shën Joan Vladimirit, me pjesëmarrje të lartë të besimtarëve. Për më shumë informacion, klikoni në ikonën e katërt.

